

VENDIM
Nr. 115, datë 13.2.2020

**PËR DHËNIEN E NDIHMËS SË MENJËHERSHME FINANCIARE
PUNONJËSIT TË SHËRBIMIT TË MBROJTJES NGA ZJARRI DHE SHPËTIMIN,
NË RAST TË DËMTIMIT TË RËNDË TË PRONËS, PËR SHKAK TË DETYRËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikave 1, shkronja “c”, dhe 2, të nenit 31, të ligjit nr. 152/2015, “Për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin”, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Punonjësi me gradë i Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin, në vijim punonjësi, përfiton ndihmë të menjëhershme financiare në rastet kur prona e luajtshme apo e paluajtshme i është dëmtuar si pasojë e veprës penale, të kryer në dëm të tij për shkak të detyrës dhe për rastin është referuar në prokurori.

2. Punonjësi, në rast të dëmtimit të rëndë të pronës së luajtshme apo paluajtshme për shkak të detyrës, përfiton ndihmë të menjëhershme financiare në masën 100% të vlerës së pronës së dëmtuar, por jo më shumë se 1 000 000 (një milion) lekë.

3. Për të përfituar ndihmë të menjëhershme financiare, punonjësi duhet të disponojë titull pronësie, bashkëpronësie apo dokument që vërteton procesin e legalizimit të pronës së dëmtuar.

4. Punonjësit i jepet ndihmë e menjëhershme financiare, sipas këtij vendimi, vetëm në rast se nuk ka përfituar dëmshpërblim nga shoqëritë e sigurimit, sipas legjislacionit për veprimtarinë e sigurimit dhe të risigurimit.

5. Për përfitimin e ndihmës së menjëhershme financiare, punonjësi paraqet kërkesë zyrtarisht pranë kryetarit të bashkisë përkatëse, shoqëruar nga dokumentacioni që kërkohet sipas këtij vendimi.

6. Kryetari i bashkisë përkatëse urdhëron, brenda 5 (pesë) ditëve nga paraqitja e kërkesës së punonjësit, ngritjen e Komisionit të Verifikimit të Faktit dhe Vlerësimit të Dëmit, në vijim Komisioni, në përbërje të të cilit duhet të ketë edhe specialistë të vlerësimit të pronave të luajtshme apo të paluajtshme.

7. Komisioni verifikon faktin e dëmtimit të pronës, sipas pikës 1, të këtij vendimi, bën vlerësimin e dëmit të shkaktuar dhe i paraqet kryetarit të bashkisë, jo më vonë se 10 (dhjetë) ditë nga miratimi i urdhrit për ngritjen e tij, dokumentacionin, si më poshtë vijon:

- a) procesverbalin, i cili duhet të përmbajë rekomandimet përkatëse;
- b) kërkesën me shkrim të punonjësit të Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin;
- c) kopje të njëzuar me origjinalin të shkresës për referim të veprës penale në prokurori;
- ç) dokumentacionin që provon titullin e pronësisë, bashkëpronësisë, apo procesin e legalizimit, mbi pronën e dëmtuar;
- d) çdo dokument të administruar nga Komisioni.

8. Ndihma e menjëhershme financiare jepet me urdhër të kryetarit të bashkisë, bashkëlidhur të cilit duhet të jetë dokumentacioni i administruar nga Komisioni.

9. Nëse provohet që ndihma e menjëhershme financiare është dhënë në kundërshtim të përcaktimeve të këtij vendimi ose në vendimin e organit procedues rezulton se dëmi i shkaktuar nuk ka ardhur për shkak të detyrës, punonjësi është i detyruar të kthejë në masën 100% shumën e përfituar.

10. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi përballohen nga buxheti i njësive të vetëqeverisjes vendore.

11. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama